



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 655/7 prot.

Tiranë, më 18.11.2024

**V E N D I M**

**Nr. 282, datë 18. 11. 2024**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup>”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>2</sup> mori në shqyrtim ankesën me nr.94 Regj., datë 30.04.2024, e paraqitur nga znj. F.M , kundër Shoqërisë “Alba Box ” sh.p.k, z. N.L , Administrator i Shoqërisë “Alba Box” sh.p.k dhe z. E. I , përfaqësues me porkurë i ortakut të shoqërisë “Alba Box” sh.p.k, në të cilën pretendon diskriminim për shkak të “gjinisë”, “identitetit gjinor”, “gjendjes shoqërore”, “gjendjes familjare”, “gjendjes civile” dhe “çdo shkak tjetër”

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Ankuesja, znj. F.M , në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit shprehet se: “Unë ligjërisht jam e martuar me shtetasin N.L që prej vitit 2013, i cili ka në zotërim kuotat dhe është administrator i shoqërisë Alba Box me Nipt L91515501M që prej vitit 2019. Në këtë kompani unë që prej vitit 2019 kryej detyrat e ekonomistes së brendshme.

Që prej muajit shtator 2023 e në vijim, kemi filluar procedurat e ndarjes. Gjatë gjithë kohës që kemi filluar procedurat e ndarjes ka filluar të ketë një sjellje arrogante, fyese, tallëse, madje kur jemi vetëm pa prezencën e punëtorëve më ofendon, madje ka arritur deri aty ku thotë do të të hedh si leckë në rrugë dhe kurrë nuk të lë ti gëzosh të drejtat e tua. Më drejtohet duke më thënë se jam askushi dhe madje që do të arrijë të më bëjë para se të ndahemi me gjykatë që do të më çojë deri

<sup>1</sup> Në vijim do t’i referohemi si LMD.

<sup>2</sup> Në vijim do t’i referohemi si Komisioneri.

*në vetvrasje. Dhe realisht me sjelljen e tij fyese, plot ofendime, realisht po më ezauron nga sistemi nervor.*

*Unë kam një fëmijë për të rritur dhe kam nevojë të punojë, sepse ai bën babain vetëm në telefon dhe kur ka kohën e lirë. Ju vë në dijeni se këtë ankesë ia kam drejtuar edhe sistemit të bashkëqeverisjes, ku erdhi grupi i inspektimit të inspektoriatit të lartë. Kam nevojë të punojë të mbaj veten dhe fëmijën tim prandaj paraqitem në punë.*

*Unë jam në proces ndarje nga bashkëshorti im N.L , njëkohësisht edhe administrator i Alba Box sh.p.k Për shkak se ne kemi kuotat të ardhura gjatë martesës 50% të kuotave të kësaj shoqërie, ai nuk dëshiron ndarje sipas ligjit dhe që kur ka ndërmarrë veprimet e kalimit dhe rikthimit të kuotave që nga muaji shkurt, që prej ketij momenti ka filluar i gjithë procesi i mosmarrëveshjeve dhe i fillimit të të gjitha fyerjeve dhe ofendimeve që bashkëshorti im (administratori) ka filluar ndaj meje. Sipas tij, me qëllimin e vetëm si janë fjalët e ti, që të më shtyjë deri në vetvrasje se kështu shpëtojnë kuotat e tij (siç shprehet). Aktualisht pas përgjigjes së Inspektoriatit të Lartë, gjendja është rënduar akoma më shumë pasi edhe përfaqësuesi me prokurë të përgjithshme i ortakut shtetasi E. I , ka filluar një agresivitet dhe ofendime të herëpashershme ndaj meje, pasi nga inspektimi u gjendën mangësi në menaxhim dhe faji është i imi sipas tij, sepse kam bërë ankesë për diskriminimin tim si bashkëshorte, si femër, si punonjëse, si nënë, pranë biznesit familjar. Ankesat e mia deri tani vetëm sa kanë rënduar situatën, nuk është se po marr ndonjë ndihmë.*

*Kam nevojë të punoj e qetë. Nuk po shqetësoj asnjë për kuotat apo të drejta të tjera të miat brenda biznesit sepse ka gjykatë, por nuk mund të më urdhërojnë ata shko me pushime se nuk duam të të shohim se nuk je asgjë apo gjëra si këto dhe me rëndë..*

*Aktualisht janë bërë kallëzime penale ndaj bashkëshortit tim për dhunë në familje (dy kallëzime një në datën 09.04.2024 dhe në datën 22.04.2024). Aktualisht që po ju shkruaj jam me urdhër të menjëhershëm mbrojtje të lëshuar në datën 11.04.2024 nga Gjykata e Rrethit Durrës (data e të cilit për verifikim është në datën 29.04.2024”*

Përfundimishta ankuesja kërkon nga Komisioneri hetimin e çështjes dhe marrjen e masave sipas ligjit.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Në nenin 1 të LMD, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet

*gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Diskriminimi përkufizohet nga LMD, në nenin 3, pika 1, si “*çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

Në bazë të nenit 7, të LMD, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet nga *çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë*, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë.

1. Në kuadër të shqyrtimit paraprak u konstatua se ankesa nuk ishte e plotë për të vijuar shqyrtimin e saj. Me shkresën nr. 655/2 prot., datë 07.05.2024, Komisioneri iu drejtua ankueses me kërkesë për informacion, duke kërkuar ndër të tjera:

- Saktësimin e subjekteve kundër të cilëve është paraqitur ankesa.
- Shpjegime për secilin shkak diskriminimi të pretenduar si dhe ndërthurjen e tyre në raport me faktet dhe rrethanat e parashtruara.

1.1 Me shkresën e datës 11.05.2024, e cila është administruar pranë Komisionerit me nr.655/4 prot, datë 14.05.2024, ankuesja ka kthyer përgjigje duke depozituar dokumentacionin e kërkuar dhe duke parashtruar si vijon:

Alba Box sh.p.k është një shoqëri ku ne si bashkëshortë, F. L dhe N.L kemi 50% të kuotave. Ne kemi që në shtator 2023 që jemi të ndarë fizikisht, pra nuk jetojmë në të njëjtën banesë. Deri në dhjetor 2023 unë me bashkëshortin nënshkruam akt-marrëveshjen për zgjidhje martesë me mirëkuptim, pasi mendoja dhe besoja se vërtetë ai do kujdesej për djalin tonë L. L, edhe pas ndarjes. Por në fakt ndodhi krejt e kundërta.

Ai filloi që në janar, duke e bërë ambientin e punës totalisht të vështirë, duke filluar batuta dhe ofendime që pasoheshin nga shtetasi italian E. I , i cili është përfaqësuesi me prokurë të përgjithshme i ortakut tjetër italian në kuotën 50%. Në fillim ishin batuta dhe ofendime, më pas kaloi në veprime konkrete duke fshehur pasurinë e vetme bashkëshortore që ne krijuam, pra kuotat 50% e Alba Box sh.p.k. Kur e mora vesh këtë dhe i kërkoja llogari, gjendja u agravua shumë midis nesh, duke më thënë që nuk kisha për të marrë asnjë unë dhe djali, sepse ai s’do kishte nevojë për veprime të tjera ligjore se do arrinte deri në atë pikë sa do të më çonte deri në vetvrasje. Në këto kushte iu drejtova Inspektoriatit dhe bashkëqeverisjes, në shenjë dëshpërimi, të cilët më orientuan tek Komisioneri.

Ndërkohë që erdhën për kontroll Inspektoriati i Punës, ai përveç sjelljes që bënte ndërkohë, pra ishte harbut në komunikim, ofendues, tallës dhe batutat e tij mbështeteshin nga italiani E. I , i cili më vinte në lojë për situatën e krijuar. N. u acarua më shumë dhe tha, nëse ta thashë me fjalë që do të të çoj deri në vetëvrasje do e shohësh çdo të bëj, të bëhet fakt. E trembur iu drejtova Komisarariatit Durrës, ku aktualisht jam edhe me urdhër mbrojtje. Në këto kushte u detyrova të heq dorë nga marrëveshja me mirëkuptim dhe pushova çështjen e zgjidhjes së martesës me mirëkuptim për të vazhduar në procedurë normale, duke kërkuar të drejtat e mia dhe fëmijës tim.

Ankesa ime është në cilësinë e një gruaje e cila dhunohet dhe diskriminohet nga bashkëshorti i saj N.L , i cili njëkohësisht ushtron funksionin e Administratorit të Shoqërisë Alba Box sh.p.k, si dhe shtetasit E. I , i cili është përfaqësues me prokurë të përgjithshme nga ortaku tjetër italian. Këto veprime janë të qarta që i bëjnë pasi duan të më përjashtojnë mua dhe djalin tim nga e vetja gjë të cilën ne kemi krijuar gjatë kësaj martese 12 vjeçare.

Nuk kam patur një kontratë pune me shoqërinë Alba Box sh.p.k pasi kam qenë në cilësinë e bashkëshortes së ortakut, ndërsa sot meqë ai nuk dëshiron më të jetë bashkëshorti im, nuk meritoj të hidhem në rrugë unë dhe fëmija im, meqë ai do të ketë një jetë pa ne.

2. Me *e-mailin* e datës 28.05.2024, ankuesja informon se është njoftuar nga punëdhënësi/ Shoqëria Alba Box sh.p.k se, për shkak të rënies së volumit të punës, duke filluar nga data 01.06.2024, ankuesja do të punonte me orar pune të reduktuar çdo ditë nga e hëna në të premte nga ora 8-12, me pagën mujore neto 50 000 leke.
3. Me *e-mailin* e datës 17.06.2024, ankuesja informoi se, në datën 15.06.2024, nga ana e Administratorit të Shoqërisë z. N.L , i është komunikuar njoftimi për zgjidhjen e marrëdhënies së punës.
4. Me shkresat nr. 655/3 prot, datë 07.05.2024 dhe nr.655/6 prot, datë 05.06.2024, Komisioneri kërkoi nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH), informacion në lidhje me informacionin/dokumentacionin e administruar nga ana e këtij institucioni, në kushtet kur ankuesja deklaroi se janë kryer inspektime nga ISHPSHSH mbi bazën e ankesës së paraqitur nga ana e saj. Me *e-mailin* e datës 06.06.2024, ISHPSHSH, vendosi në dispozicion të Komisionerit informacionin në lidhje me rastin e trajtuar nga ana e tyre, pranë subjektit Alba Box sh.p.k.

Pas plotësimit të ankesës, në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

5. Me shkresën me nr.655/5 prot., datë 24.05.2024, Komisioneri ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga Shoqëria Alba Box sh.p.k, z.N.L , Administrator i Shoqërisë Alba Box sh.p.k dhe z. E. I , përfaqësues me prokurë i ortakut të Shoqërisë Alba Box sh.p.k, në cilësinë e

subjekteve kundër të cilëve është paraqitur ankesa. Ky njoftim është kthyer mbrapsh nga ana e shërbimit postar.

6. Me *e-mailin* e datës 04.06.2024, njoftimi dhe kërkesa për informacion u komunikua në adresën e *e-mailit* të publikuar nga shoqëria Alba Box sh.p.k në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB): [albabox1@mail.com](mailto:albabox1@mail.com). Marrja e *e-mailit* u konfirmua nga ana e z. N.L , Administrator i Shoqërisë Alba Box sh.p.k, nëpërmjet *e-mailit* të datës 05.06.2024.
7. Me shkresat nr.655/8 prot, datë 09.07.2024 dhe nr. 655/7 prot, datë 09.07.2024, Komisioneri iu ridrejtua sërish subjekteve kundër të cilëve është paraqitur ankesa, pasi nuk kishin depozituar informacionin e kërkuar.
8. Me shkresën e administruar pranë Komisionerit me nr.655/9 prot., datë 18.07.2024, ktheu përgjigje z.N.L , Administrator dhe përfaqësues ligjor i Shoqërisë Alba Box sh.p.k, duke parashtruar ndër të tjera se:

Në lidhje me pretendimet e paraqitura nga ankuesja, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë si individ dhe si përfaqësues ligjor i shoqërisë Alba Box sh.p.k që ato janë të pavërteta dhe të pabaza.

Në subjektin Alba Box sh.p.k. është paraqitur edhe Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, i cili po për të njëjtat pretendime të pavërteta të znj. F.M , ka mbajtur Procesverbal Inspektimi Nr. ISHPSHSH-TR-2024-002584-2, datë 04.06.2024, në të cilin nuk ka asnjë punonjës informal dhe asnjë punonjës të ofenduar apo të diskriminuar, pasi punonjësit janë marrë në intervistë nga inspektorët e ISHPSHSH.

Gjatë inspektimit nga ISHPSHSH, është konstatuar që kontrata e punës e znj. F.M (dhe çuditërisht vetëm kontrata e saj) me funksion Nëpunës Zyre në Ndërmarrje, nuk gjendej. Deklaroj se, kontrata e punës e znj. F.M ka qenë në zyrë përpara së të nisnin pretendimet e paqëna të saj, pasi subjekti është inspektuar nga ISHPSHSH çdo vit dhe nuk është konstatuar asnjë punonjës pa kontratë pune. Më datë 12.06.2024, ISHPSHSH merr Vendimin Perfundimtar të Inspektimit Nr. ISHPSHSH-TR-2024-002584-5. Theksoj se, për mosgjetjen e kontratës së punës të znj. F.M , subjekti Alba Box sh.p.k. është gjobitur nga ISHPSHSH në vlerën 120.000 lekë, për të cilën kemi apeluar, sepse znj. F.M ka pasur një kontratë pune dhe këtë e vërtetojnë inspektimet e mëparshme nga inspektoriati, ku nuk është konstatuar asnjë punonjës pa kontratë pune.

Përsëri mbi pretendimet e ngritura nga znj. F.M , pasi të njëjtat pretendime të saja ia ka shprehur edhe Zyrës së Bashkëqeverisjes, e cila në përgjigje të kërkesës së saj me numer 565576 (këtë shkresë ma ka dhënë personalisht znj. F.M në ambientet e zyrës së ndërmarrjes) shprehimisht është përgjigjur: “Nga intervistat e kryera me punëmarrësit e gjetur në vendet e punës u deklarua se në asnjë moment nuk kanë konstatuar presion ose dhunë psikologjike në ambientet e punës.”

Znj. F.M nuk është fyer, cenuar apo diskriminuar as nga unë, N.L dhe as nga ndonjë ortak i Alba Box sh.p.k, përkundrazi, jam fyer unë me fjalë dhe tone të larta dhe jo etike në ndërmarrje (kjo e vërtetuar nga kamerat e vendosura sipas ligjit në ambientet e punës) duke më krijuar vështirësi të mëdha në mbarëvajtjen e punës. Znj.F.M , është respektuar në çdo gjë që ka kërkuar, siç është dalja ime nga shtëpia me qera, qera të cilën e paguan shoqëria Alba Box sh.p.k për administratorin, por që nga muaji tetor 2023 e deri më sot këtë qera shoqëria Alba Box sh.p.k e paguan për znj. F.M .

Përsëri, për të vërtetuar pretendimet e pavërteta të znj. F.M , ku dallohet vullenti i mirë dhe për të mos pasur asnjë konflikt me mua, N.L dhe me asnjë ortak të shoqërisë Alba Box sh.p.k, Ju vë në dispozicion një marrëveshje për zgjidhje martese me mirëkuptim, të nënshkruar përpara noterit ku zj. F.M me nëshkrimin e kësaj marrëveshje do ti kaloheshin 25% e kuotave të mia dhe një vlerë monetare prej 80.000 lekë në muaj, për një afat 3 vjet. Në këtë marrëveshje verbale ka qenë prezent edhe zj. A. Z . Pas kësaj, znj.F.M refuzon këtë marrëveshje duke u shprehur “*me jep 50.000 euro të të lë rehat*”. Shoqëria Alba Box sh.p.k nuk ka pranuar ti jap znj. F.M këtë vlerë monetare. Pas kësaj, znj. F.M ka filluar me fyerje e të bërtitura në ndërmarrje, me denoncime të rreme në polici, ku jam paraqitur mbi 7 herë, në Zyrën e Bashkëqeverisjes, në ISHPSHSH, në Prokurori, në Gjykatë, etj.

Fakt tjetër për të vërtetuar që znj. F.M është munduar të më dëmtojë imazhin si individ, por edhe të dëmtojë punën e shoqërisë Alba Box shpk, ku pretendon kuota të shoqërisë e para është dhe Kërkesë Padia, Kod Anonimizimit 8937D3F4-9FA2-472D-A412-D1E49DD2CAE4, për të cilën Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës me vendim Nr. 165, datë 25.05.2024, vendim Nr. 170, datë 03.06.2024, vendim Nr.172, datë 28.05.2024, ku pretendimet për padrejtësitë dhe kuotat, fitimin e shoqërisë Alba Box sh.p.k rrëzohen.

Në asnjë moment znj. F.M nuk i është munguar respekt dhe mirëkuptim si nga unë, ashtu edhe nga ortakët dhe punonjësit e shoqërisë. Këto janë vetëm pretendimet e saj të pabazuara. Znj. F.M nuk është dhe nuk ka qenë kurrë aksionere e Shoqërisë Alba Box sh.p.k.

Duke qenë se gjatë inspektimit u la si detyrë nga inspektorët e ISHPSHSH që në kontratat e punës duhej specifikuar për çdo punonjës procesi i punës, shoqëria Alba Box sh.p.k përgatiti kontrata të reja për punëmarrësit me përshkrimin e punës për secilin nga punonjësit. Janë ndjekur në këtë proces të gjithë procedurat sipas ligjit dhe Kodit të Punës së R.SH. Janë njoftuar punonjësit për firmosjen e kontratave të punës dhe të gjithë kanë firmosur për marrjen e njoftimit, përveç znj. F.M . Ndodhur përpara këtij fakti, znj. F.M është njoftuar telefonikisht, me mesazhe të shkruara dhe me *e-mail* për këtë. Për procedurën e marrëdhënieve të punës dhe firmosjen e kontratave të punës është autorizuar z. E. I , për të proceduar, pasi unë, N.L kam dashur të jem sa më transparent

dhe i paanshëm për të mos pasur asnjë lloj konflikti të mundshëm me znj F.M . Për këtë procedurë kemi kërkuar edhe praninë e ISHPSHSH.

Znj. F.M edhe pse është paraqitur në punë dhe kontrata i është dhënë edhe në tryezën e zyrës së shoqërisë, nuk ka pranuar ta firmosë atë duke kaluar edhe afatin shtatë ditë siç e përcakton Kodi i Punës i R.SH.

Znj. F.M është punësuar me Esig 027 Nr. 2, datë 21.05.2019, në kategorinë e profesionit 4419.03 “Nëpunës të tjerë zyre.” Pozicioni i punës i znj. F.M ka qenë “Nëpunës zyre.” Detyrat sipas këtij pozicioni janë: -të plotësojë faturat tatimore të shitjeve; - të komunikojë me furnitorët për furnizimet e blerjeve; - të komunikojë me klientët për porositë e shitjeve; - të mbajë dokumentacionin ligjor dhe financiar të kompanisë; - të rakordojë me klientët dhe furnitorët për detyrimet që janë për të likuajduar; - të përgatisë dhe të vërë në dispozicion dokumentat e shoqërisë institucioneve përkatëse që vijnë për inspektim në subjekt.

Kompania Albabox sh.p.k me Nipt L91515501M, është krijuar në datën 15.03.2019. Kapitali i kompanisë është 1 250 000 lekë dhe kontributi i ortakëve në momentin e themelimit të kompanisë është: ortaku S.I me pjesëmarrje prej 40% të kuotave (përfaqësuar me prokurën nr. rep 1691 datë 19.05.2021 nga E. I ), N.L me pjesëmarrje prej 9% të kuotave, G.B me pjesëmarrje prej 51% të kuotave, administrator N.L . Në datën 19.05.2021 është larguar ortaku G.B, ortakët S.I dhe N.L bëhen zotërues me 50% të kuotave në kompaninë Albabox shpk. Kompania ka formën juridike sh.p.k, nuk është biznes familjar dhe F.M nuk është e punësuar si bashkëshorte e ortakut N.L , është e deklaruar me pozicionin Nëpunës të tjerë zyre.

Referuar listëpagesave të viti 2024, kompania ka 7 të punësuar, 4 femra dhe 3 meshkuj. Në listëpagesën qershor 2024, janë të punësuar 4 femra dhe 3 meshkuj, nuk është bërë asnjë zëvendësim i punëtoreve femra me meshkuj. Referuar listëpagesave 2024 pozicionet e punës janë:

N.L :	Esig027 nr. 1 datë 18.03.2019 Detyra, Funkzioni apo Puna që do të kryejë: 1120.28 Administrator;
E. I :	Esig027 nr. 2 datë 21.05.2019 Detyra, Funkzioni apo Puna që do të kryejë: 1221.04 Drejtor i shitjeve;
F.M :	Esig027 nr. 2 date 21.05.2019 Detyra, Funkzioni apo Puna që do të kryejë: 4419.03 Nëpunës të tjerë zyre;
A.M:	Esig027 nr.5date 10.03.2021 Detyra, Funkzioni apo Puna që do të kryejë: 9622.03 Punëtor ndihmës;
T. M:	Esig027 nr. 8 datë 21.05.2023 Detyra, Funkzioni apo Puna që do të kryejë: 9622.03 Punëtor ndihmës
L.K:	Esig027 nr. 10 datë 31.05.2023 Detyra, Funkzioni apo Puna që do të kryejë: 9622.03 Punëtor ndihmës

D.V: Esig027 nr. 12 datë 03.10.2023 Detyra, Funkzioni apo Puna që do të kryejë:  
9622.03 Punëtor ndihmës

Punonjësve të Shoqërisë Alba Box sh.p.k iu është vënë në dispozicion Kodi i Punës së R.SH përpara nënshkrimit të kontratave të punës ku përcaktohen qartë marrëdhëniet e punës midis punëdhënësit dhe punëmarrësit.

Ankuesja nuk ka paraqitur asnjëherë një ankesë për diskriminim dhe shqetësim në vendin e punës, sepse këto nuk kanë ekzistuar kurrë, përkundrazi ankuesja ka pasur një pozicion shumë tolerant dhe mirëkuptues duke qenë se ka qenë bashkëshortja e z.N.L , përfaqësues ligjor i shoqërisë Alba Box sh.p.k. Ankesat e znj.F.M fillojnë në momentin kur znj. F.M dhe z. N.L janë në një proces divorci.

Edhe pas pretendimeve të znj. F.M si *“dua tani 25% të kuotave të shoqërisë Alba Box sh.p.k.”*, *“dua tani të ndahet fitimi i shoqërisë dhe të më jepet 25% e fitimit”*, në prezencën e avokates së saj znj. A. Z , i është ofruar verbalisht 25% të kuotave dhe një pagesë 80.000 lekë në muaj për një afat kohor tre vjet, pra një vlerë 2.880.000 lekë, kjo për të mos pasur konflikte dhe për një zgjidhje martese sa më paqësore. Kjo marrëveshje nuk u arrit, pasi në një moment të dytë znj. F.M kontakton me shoqërinë duke u shprehur *“nuk kam nevojë për lëmoshë dhe tani do ta shikoni ju”*. Pas kësaj shoqëria është munduar ti shpjegojë që për sa i përket 25% të kuotave të shoqërisë znj. F.M do ti marrë me përfundimin e ndarjes së pasurisë, pas divorcit me z. N.L me një vendim gjykate. Për sa i përket ndarjes së fitimit të shoqërisë kjo vendoset nga asambleja e ortakëve të shoqërisë sipas ligjit *“Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare në Republikën e Shqipërisë”*. Përveç kësaj, theksoj se, shoqëria Alba Box sh.p.k ka rezultuar me fitim për periudhën tatimore 2023, por shoqëria ka edhe detyrime ndaj të tretëve dhe institucioneve të kredisë.

Në lidhje me ankesat e znj. F.M drejtuar Shoqërisë Alba Box sh.p.k, z. N.L dhe z. Edgardo Iancarrelli, Ju sqarojmë:

Në lidhje me diskriminimin në punë

N.L si bashkëshort i F.M t kishte detyrimin të respektonte vendimin e gjykatës për urdhër mbrojtje, sipas të cilit ai nuk duhet të kontaktonte dhe ngacmonte F.M n, urdhër mbrojtje i nxjerrë nga gjykata për shkak të marrëdhënieve familjare burrë dhe grua midis tyre. Ndërkohë N.L është administrator i Alba Box sh.p.k, ku F.M ishte e punësuar dhe puna e saj kryhej në të njëjtën zyrë me të.

Ndodhur në një situatë të tillë për të respektuar urdhrin e mbrojtjes nga Gjykata, Administratori N.L , i kërkoi F. të mosparaqitje në punë dhe paga e saj do të vazhdonte të hidhej në llogarinë bankare. F. nuk e zbatoi këtë kërkesë dhe paraqitej në punë çdo ditë duke shqetësuar të gjithë kolektivin. Administratori nuk e ngarkonte me asnjë punë dhe shmangte çdo kontakt me të, ndërkohë që ajo kërkonte konflikt në çdo kohë dhe rrinte në zyrë me të.



Ankesa e saj te inspektorati i punës nuk kishte të bënte me kushtet e punës së saj, as me pagën dhe me asnjë gjë tjetër, pasi asnjë e drejtë nuk i ishte shkelur. I fyer dhe kërcënuar ka qenë N.L dhe jo ajo. Për të provuar veprimet e dhunshme të saja për të hyrë me forcë në selinë e shoqërisë dhe në zyrë kërkohet të merren si provë regjistrimet e kamerave të ambienteve të zyrave dhe të pyeten të punësuarit e tjerë të kësaj kompanie. F. ka bërë inaktive kamerat në momentet kur ajo ka shkelur ligjin hapur në zyrat e shoqërisë me fyerjet dhe sharjet e saj si hysterike.

Shoqëria ka një numër shumë të vogël punonjësish nga të cilat një Drejtor shitje, E. I dhe një Nënpunës zyre, F.M . Ndodhur në këtë kushte, njëri prej tyre do të mbante dosjet e personelit. Edgardo kurrësesi nuk mund të kishte lidhje me dosjet e personelit, pasi puna e tij kishte lidhje me shitjet dhe e vetmja që kishte për detyrë të mbante ato ishte F. . Ajo është punonjësja e vetme që ka pasur dosjet e punës dhe rrjedhimisht dhe të sajën. E ka zhdukur dosjen e saj dhe kontratën e punës me qëllim që të dëmtonte shoqërinë dhe të dënoheshim me gjobë ashtu siç ndodhi nga Inspektorati i Punës për mungesë kontrate të punës së saj. Një sjellje e tillë është papranueshme për një punëmarrës. F. ka qenë e punësuar dhe nuk kishte asnjë mundësi të mos kishte kontratë pune. Marrëdhënia e saj si bashkëshort me N. nuk e shmangte dot moslidhjen e kontratës së punës. Në bazë të nenit 21 dhe 202 të Kodit të Punës kontrata e punës është e detyrueshme, pasi në mungesë të saj punëdhënësi penalizohet me gjobë, ashtu siç edhe ndodhi nga Inspektorati i Punës.

Në vendin e punës ajo nuk është diskriminuar për asnjë moment përkundrazi është privilegjuar pasi është paguar pa kryer punë dhe është lejuar të përdor fjalor fyes dhe poshtërues. Një punëmarrës nuk mund të sillet në këtë mënyrë me punëdhënësin. Marrëdhënia e punës kërkon raporte besimi dhe në momentin që këto raporte nuk ekzistonin më marrëdhënia e punës nuk mund të vazhdonte dhe i takonte vet F. të largohej nga puna. Për shkak të situatës së ndërlidhur me marrëdhëniet familjare, Administratori nuk ndërmori asnjë veprim për të zgjidhur kontratën e punës, por me durim dhe tolerancë nuk ju përgjigj provokimeve të F. , për të shmangur një urdhër të ri mbrojtje dhe një dënim penal për dhunë në familje. Për të shmangur çdo keqkuptim se veprimet e tij ishin të ndërlidhura nga marrëdhëniet familjar e nuk ndërmori asnjë veprimi si administrator, por çdo vendimmarrje ja drejtoi asamblesë së ortakëve.

Marrëdhënia e punës u ndërpre për shkak të sjelljes së F. , e cila brenda 7 ditëve nuk denjoi të lidhte kontratën e punës, kontratë e cila ishte lënë detyrë nga Inspektorati i Punës dhe shoqëria ishte dënuar me gjobë për këtë fakt. Ky detyrim është i pasqyruar në Kodin e Punës neni 21/4: *“4. Për raste të veçanta dhe të justifikueshme, nëse kontrata nuk është lidhur sipas pikave 1 dhe 3, të këtij neni, punëdhënësi është i detyruar ta lidhë atë brenda 7 ditëve nga dita e punësimit.”*

Ju paraqesim si provë kontratat e punës që janë rilidhur me të gjithë të punësuarit në zbatim të detyrimeve të ISHPSHSH, kontratën e pafirmosur nga F.M , njoftimin drejtuar kësaj shtetase për të lidhur kontratën dhe njoftimin për zgjidhje kontrate.

Pretendimet për diskriminim të F. janë fjalë boshe, të përgjithshme, jo konkrete dhe kanë provë vetëm thëniet e saj. Një punëmarrës që nuk respekton zbatimin detyrimet ligjore nuk mund të quhet i diskriminuar.

#### Në lidhje me diskriminimin ekonomik

F. dhe N. i në kohën që ishin të martuar dhe në marrëdhënie normale martesore jetonin me qira në qytetin e Durrësit ku qiraja paguhej nga shoqëria. Pas ndërprerjes së bashkëjetesës që nga tetori 2023 në banesë jeton F. dhe N. i është larguar. Qiraja nga tetori 2023 e deri në qershor 2024 është paguar nga shoqëria megjithëse shoqëria nuk kishte asnjë detyrim të paguante qiranë e shtëpisë së një të punësuarë. Pra, ajo ka qenë e privilegjuar dhe jo e diskriminuar ekonomikisht. Ju paraqesim si provë mandatet e bankës për pagimin e qirasë. Kjo sjellje tregon tolerancën e N. it dhe jo fuqinë vendimmarrëse ligjore si administrator.

Nga ana tjetër për problemet ekonomike, për kuotat që ajo pretendon në shoqëri, për dëmin e shkaktuar nga zgjidhja e martesës dhe stresin e shkaktuar, ajo i është drejtuar Gjykatës së Durrësit dhe Komisioneri në këtë rast nuk ka juridiksion të hetoj dhe marr vendim administrativ.

#### Në lidhje me diskriminimin familjar.

Nuk e kuptoj ku është ky diskriminim. E zgjidhëm me marrëveshje martesën dhe detyrimet ndaj djalit dhe ishte F. që e shkeli atë. Në asnjë moment unë nuk kam braktisur djalin, as edhe e kam lënë pa paguar detyrimin ushqimor, në fillim vullnetarisht dhe më pas në respektim të vendimit të gjykatës në shumën prej 20 000 lekë në muaj, vendim që jua vë në dispozicion. Përkundrazi jam unë i diskriminuar që kam disa muaj që nuk po arrij të takoj djalin dhe djali të takoj të atin. Duke qenë në një sjellje të tillë prej saj, i kam kërkuar gjykatës ta mbaj unë për rritje dhe edukim djalin, kërkesë e cila mu rrëzua. Paraqita kërkesë tjetër për pasur mundësi takimi në ditë të caktuara dhe ta mbante ajo djalin dhe përsëri mu rrëzua. Akoma nuk kam marrë vendimet e arsyetuara të gjykatës dhe jam i shokuar nga këto vendimmarrje. Këto vendime janë të paankimueshëm dhe rrjedhimisht të formës së prerë. Jam shumë i shqetësuar për djalin, pasi është në një situatë të rëndë stresi dhe ka nevojë për praninë e të atit. F. nuk ka një sjellje normale dhe bën veprime të paarsyeshme që më krijojnë pasiguri në sjelljen e saj edhe me djalin. Ajo ka bërë kallëzime pa fund në polici, të cilat nuk kanë asnjë elementë penal. Është kjo shtetase që vjen në zyrat e shoqërisë, provokon, bërtet dhe pastaj bën kallëzim se unë e kam dhunuar psikologjikisht. Kjo sjellje nuk është normale dhe kjo sjellje ka pasoja të rënda mbi fëmijën. Kërkoj të merrni masa për diskriminimin familjar ndaj djalit L. L për mos takim me të atin dhe të kryer ndaj meje për mos lejim të takimit prej meje të fëmijës.

9. Me shkresën e administruar pranë Komisionerit me nr. 655/11 prot., datë 13.08.2024, ankuesja ka depozituar papësimet e saj, duke parashtruar ndër të tjera:

Është i vërtetë fakti që unë dhe djali ynë kemi jetuar në një apartament që paguhej nga Alba Box sh.p.k (banesë e cila deri në shtator 2023 ka qenë banesa jonë bashkëshortore). Deri në datën

05.07.2024, deri sa më njoftoi pronari i apartamentit që duhet ta liroja se Alba Box sh.p.k nuk e paguante më, kam jetuar në atë apartament bashkë me djalin dhe aktualisht, pasi bashkëshorti im pas largimit në mënyrë harbute dhe jashtë çdo parashikimi ligjor më largon nga Alba Box sh.p.k, nuk i kishte ngelur gjë për të bërë si si mund të më trazonte mua psikologjikisht, gjen pretekstin e apartamentit, dhe normalisht në kushtet kur unë në atë muaj isha pa punë (pra muaji korrik), nuk e pashë të arsyeshme të qëndroja në një apartament ku qiraja ishte ngritur që në muajin maj 2024. Aktualisht jetoj me djalin në një apartament që e paguaj vetë dhe jam në një marrëdhënie të re pune. Djali ynë ka numër telefoni personal për komunikimin me të atin.

Z.N.L nuk ka bërë asnjë propozim në lidhje me ndarjen e kuotave me mirëkuptim. Nuk ka bërë asnjë propozim konkret, e cila të jetë ligjore, pasi ligjin e bën z.N. , siç është shprehur ai gjithmonë. Propozimi që z.N. përmend për një pagesë 80.000 lek/muaj për një afat 3 vjeçar, në lidhje me likuidimin e 25 % të kuotave të Alba Box sh.p.k që më takojnë sipas bashkëshortit tim, nuk ishte refuzim total nga ana ime, por i bëra një propozim tjetër që z.N. nuk e pranoi. I vërtetë është edhe fakti që prezent ka qenë znj.A. Z (avokatja ime) por unë nuk kam qenë prezent, dhe ajo i tha që nuk duam të caktohet kjo vlerë, pasi ne duam një auditim financiar që nga koha kur kemi qenë ortak në vlerën 9 % deri në ditën që po bëhet ndarja dhe do marr as sa më takon, mbase i bie më pak se 80 000 lek. Por kjo nuk i pëlqeu bashkëshortit tim, se nuk dinte si të mbulojë vjedhjet që ka bërë dhe vazhdon të bëjë. Kurrë nuk i kam caktuar vlerë dhe e vetmja përgjigje që i kam dhënë bashkëshortit tim, është që, unë do të marr nga kjo martesë dhe nga Alba Box sh.p.k aq sa do të më japë gjykata, por pikërisht kjo shprehje nuk i pëlqen bashkëshortit tim.

Në jemi në proces zgjidhje martesë pa mirëkuptim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, proces i cili vazhdon pranë kësaj gjykate, dhe jemi gjithashtu në një proces të dytë për pavlefshmërinë e një vendimi asambleje, ku më përgjysmonte pagën time, edhe ky proces është duke u zhvilluar pranë të njëjtës gjykatë.

Z. N. sërisht vazhdon të deklarojë që më ka larguar nga puna me procedurë. Në lidhje me këtë pikë ju vë në dijeni si më poshtë:

Kam qenë në marrëdhënie pune me Alba Box sh.p.k, marrëdhënie pune e cila ka filluar në datë 22.05.2019, punë të cilën e kam kryer pa bërë shkelje, deri në momentin e largimit nga puna, ku jam komunikuar me urdhrin e brendshëm për largim të menjëhershëm, pa njoftim dhe pa procedurë paraprake më datë 15.06.2024, me *email* nisur ditën e shtunë më datë 15.06.2024, ora 18:08, me përmbajtje “*Zgjidhje të marrëdhënies së punës në zbatim të procesverbalit dhe vendimit përfundimtar të Inspektoriatit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Sociale*” për lirimin tim nga detyra, shkresë e cila më është komunikuar zyrtarisht nga punëdhënësi im (bashkëshorti im) nga *emaili* zyrtar i shoqërisë Alba Box sh.p.k. Urdhri i largimit nga puna nuk ka dhënë asnjë shkak apo arsyetim ligjor. Në librezën e punës është bërë shënim “*largim me procedurë*”, por vetëm procedura nuk është shpjeguar përveç urdhrin të largimit që më është komunikuar me *email*, ku thuhet se është një nga kërkesat dhe detyrat e lëna nga Inspektoriatit i Punës.

Në lidhje me procedurën e pretenduar nga punëdhënësi im, bashkëshorti im, ju bëj me dije se: në datën 06.06.2024, nga *email* i shoqërisë Alba Box sh.p.k, erdhi një njoftim mjaft urgjent, ku njoftohem për mbledhjen e datës 07.06.2024, ku ishim të lutur ne punonjësit të paraqiteshim për rinovim të kontratës së punës. Rinovim, pasi punëdhënësi im, bashkëshorti im, gjatë kontrollit të Inspektoriatit të Punës, rezultoi që kishte humbur kontratat e punës dhe nuk kishte kopjet e punëdhënësit sipas Kodit të Punës dhe për këtë shkak kërkoi rinovim urgjent.

Për shkak të problemeve të shumta që unë kam me z.N.L , në cilësinë e bashkëshortit tim, probleme që filluan që kur nisi zyrtarisht procesi i zgjidhjes së martesës dhe nga pretendimet që unë kisha mbi kuotat e shoqërisë (procese këto që po shqyrtohen pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës), për shkak të konfliktit të interesit që kishte me mua z.N. , sipas Statutit të shoqërisë Alba Box, ngarkon përfaqësuesin e ortakut tjetër të shoqërisë, për të kryer kontratat e reja të punës, përfshirë edhe timen. Në këtë kuadër, kur ne për shkaqet e luftës për kuotat dhe presioneve të shumta psikologjike që ka ushtruar në mënyrë të vazhdueshme z.N.L (ndaj të cilit kisha edhe një urdher mbrojtje të lëshuar nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës i datës 27.04.2024), i kërkova z. E. I , përfaqësuesi i punëdhënësit, një kopje të kontratës që ta konsultoja mënjane, së bashku me avokaten time, siç kam të drejtë sipas ligjit, pra Kodit të Punës. Kjo gjë jo vetëm iu tha me gojë në datën 07.06.2024 gjatë mbledhjes, por edhe në komunikimin me *email* në datën 10.06.2024, ku vazhdojmë ti kërkojmë një kopje të kontratës së punës, që ta lexojmë me qetësi, sipas kohës që na jep ligji. Gjithashtu e vë në dijeni sipas komunikimeve të shumta që kam patur edhe me *email*, ku i kërkoj të më vëre në dispozicion *passwordet* e punës, pasi po ma bënin punën të pamundur. Duke qënë se edhe me klientët nuk kisha komunikim, se mi kishte ndërprerë z.N.L , madje as porosi nuk bëja dot më për blerje apo shitje, pra përfundimisht punën ma kishte bërë të pamundur që para se të largohesha nga puna.

Kjo luftë ndaj meje nuk ishte se kisha bërë gabime në punë apo i kam shkaktuar dëme firmës, por për shkak se nuk i bindesha më tekave të bashkëshortit tim dhe kërkoja të drejtat që më takonin, për këtë shkak arritëm në këtë pikë. Ndërkohë që prisja kontratën e punës, që nuk mu vendos kurrë në dispozicion, për shkak se djali ynë kishte mbaruar shkollën dhe vendosëm bashkarisht të kisha dy ditë leje, pra pushim datën 13.06.2024 dhe datën 14.06.2024 (që i binin e enjte dhe të premte) dhe ditën e shtunë 15.06.2024, në mbasdite më vjen largimi nga puna me pretekstin se kishte zbatuar procedurën. Largimi im është bërë nga punëdhënësi në kundërshtim me kriteret dhe kushtet që kërkon ligji dhe pikërisht Kodi i Punës.

Zgjidhja e kontratës nga punëdhënësi, konsiderohet pa shkaqe të arsyeshme, kur:

- Punëmarrësi ka pretendime që rrjedhin nga kontrata e punës;
- Punëdhënësi ka përmbushur një detyrim ligjor;
- Shkelet e drejta e mosdiskriminimit;
- Bëhet për motive që lidhen me ushtrimin e të drejtave kushtetuese;

- Bëhet për motive të anëtarësimit ose jo të punëmarrësit në një sindikatë të krijuar sipas ligjit;
- Bëhet pa përcaktuar arsytet e zgjidhjes së kontratës.

Ky largim është bërë absolutisht pa shkaqe të arsyeshme dhe pa zbatuar afatin prej tre muaj, sipas nenit 143 të Kodit të Punës për marrëdhëniet e punës pa afat, si dhe pa zbatuar procedurën e largimit nga puna të parashikuar në nenin 144 të Kodit të Punës. Ky pretendim provohet nga fakti se bashkëshorti im nuk ka pasur asnjë motivacion për të motivuar vendimin e pushimit. Në këtë rast unë nuk kam bërë asnjë shkelje disipline që të pretendohet si masë për zgjidhjen e marrëdhënies së punës. Bashkëshorti im ka marrë një vendim ekstrem pa u thirrur, ballafaquar, arsyetuar dhe komunikuar nga punëdhënësi, jashtë çdo lloj norme dhe sjellje të kushtëzuar nga ligji.

E gjitha sa më sipër ka nisur për dy shkaqe: I pari, kur unë nuk vazhdova për zgjidhjen e martesës me mirëkuptim dhe e dyta, kur denoncova pranë administratorit të shoqërisë z.N. , që dyshoja për një punonjëse të Bankës Credins, znj.O.T, që mund të kishte fallsifikuar firmat e administratorit. Por në fakt, më vonë mësova që ajo kishte një lidhje me bashkëshortin tim, të cilët bashkëjetojnë bashkë sot. Pra, unë thjesht preka interesat e z.N. në dy vende ku nuk duhej, kuotat e shoqërisë dhe lidhjen e tij jashtëmartesore.

10. Bazuar në nenin 33/8, të LMD, ku parashikohet: *“Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar”*, për të sqaruar të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, Komisioneri zhvilloi një seance dëgjimore në datën 23.09.2024. Seanca dëgjimore u zhvillua me pjesëmarrjen e të gjitha palëve pjesë e procedurës administrative, ankueses F.M dhe përfaqësueses së saj Av. A. Z , me Liçencë Nr.4365, z. N.L , Administrator dhe përfaqësues ligjor i Shoqërisë Alba Box sh.p.k, z. E. I , përfaqësues me porkurë i ortakut të shoqërisë “Alba Box” sh.p.k, si dhe avokatit të tyre Av. T. H, me liçencë Nr.10761.

11. Në datën 05.10.2024, Av.T.H, paraqiti një kërkesë (me *email* datë 05.10.2024) për pushim të çështjes objekt shqyrtimi para Komisionerit, pasi e njëjta ankesë e F.M , për diskriminim në marrëdhëniet e punës, është duke u shqyrtuar me padi nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, nga gjyqtare E.Sh, me nr.21243-02425-11-2024, datë regjistrimi 3.9.2024, datë hedhje në short 5.9.2024.

12. Me shkresën nr.655/16 prot., datë 08.10.2024, Komisioneri iu drejtua me një kërkesë për informacion Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës. Me shkresën nr.93 prot datë 17.10.2024, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, ktheu përgjigje, duke informuar ndër të tjera se:

“Në bazë të verifikimeve të kryera në Sistemin ICMIC (Sistemi informatik i menaxhimit të çështjeve gjyqësore) rezulton e regjistruar çështja civile me nr.21243-02425-11-2024 Regj.Them., Nr.3535 Akti, datë 06.08.2024, regjistrimi që i përket:

Paditës: F.M I paditur: Shoqëria Alba Box sh.p.k,

Objekti i padisë: 1- Konstatimin e largimit të menjëhershëm nga marrëdhënia e punës dhe të pajustificuar. 2- Deklarimin e pavlefshmërisë të zgjidhjes së marrëdhënies të punës me të paditurin. Deklarimin e pavlefshmërisë absolute të Urdhrit të largimit datë 15.06.2024 dhe rikthimin në punë.

3-Detyrimin e të paditurit të më dëmshpërblejë 1 vit pagë mujore, për zgjidhjen e pajustificuar të marrëdhënies të punës në bazë të nenit 146/3 të Kodit të Punës. 4- Detyrimin e të paditurit të më shpërblejë pagën për periudhën e afatit të njoftimit 3 pagash mujore. 5- Detyrimin e të paditurit të më shpërblejë pagën për moszbatim të procedurës së zgjidhjes së marrëdhënies së punës prej 2 muaj pagash mujore.

6- Shpërblim për vjetërsinë në punë që nga fillimi i vjetërsisë në punë sipas nenit 145 të K.P.

7- Detyrimin e të paditurit të më dëmshpërblejë me 1 vit paga mujore, për zgjidhjen e pajustificuar të marrëdhënies të punës në bazë të nenit 155 të Kodit të Punës. 8- Detyrimin e të paditurit të më dëmshpërblejë me 6 muaj pagash mujore në bazë të nenit 148 të Kodit të Punës. 9- Konstatimin e faktit të diskriminimit dhe viktimizimit ndaj paditësit e kryer nga punëdhënësi Shoqëria Alba Box sh.p.k. 10- Ndreqjen e shkeljeve ligjore dhe pasojave të ardhura duke detyruar punëdhënësin Alba Box sh.p.k të rikthejë paditësin në vendin e mëparshëm të punës në pozicionin e mëparshëm të punës pranë palës së paditur ose në një pozicion të barazvlefshëm me të. 11- Detyrimin e punëdhënësit Shoqëria Alba Box sh.p.k të dëmshpërblejë paditësin duke e kompensuar për dëmet pasurore të shkaktuara në formën e fitimit të munguar e pagës që prej datës 15.06.2024 deri në rikthimin e tij në pozicionin e punës. 12- Detyrimin e punëdhënësit Shoqëria Alba Box sh.p.k të dëmshpërblejë paditësin për dëmin jo pasuror. 13 – Dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm.”

Nga ana e Gjykatës, është vendosur në dispozicion edhe një kopje e kërkesë padisë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të depozituar pranë Komisionerit, konstatohet se, ankuesja znj. F.M, i është drejtuar me një kërkesë padi për zgjidhjen e marrëdhënies së punës, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës me të paditur ish punëdhënësin e saj, Shoqërinë Alba Box sh.p.k.

Bazuar në parashtrimet dhe dokumentacionin e depozituar nga pala ankuese në këtë proces, Komisioneri vëren se, në analizë të kërkesëpadi së ankueses drejtuar Gjykatës të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës (në vijim Gjykatës), rezulton se pretendimi i ngritur nga ankuesja për diskriminim në marrëdhëniet e punës, është bërë objekt i shqyrtimit gjyqësor.

Komisioneri konstaton se, në kërkesë padinë e bërë nga ankuesja pranë Gjykatës, ndër të tjera ajo ka përcaktuar si objekt: “ 9- Konstatimin e faktit të diskriminimit dhe viktimizimit ndaj paditësit e kryer nga punëdhënësi Shoqëria Alba Bos sh.p.k. 10- Ndreqjen e shkeljeve ligjore dhe pasojave të ardhura...”, ndërsa ka identifikuar qartësisht si bazë ligjore të kërtimeve të saj, nenin 18 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*parimi i parazisë dhe mosdiskriminimit*), nenin 14, të Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut, të Këshillit të Evropës (*ndalimi i diskriminimit*), nenin 9 (*ndalimi i diskriminimit*) e 146 (*zgjidhja e kontratës pa shkaqe të arsyeshme, ku specifikisht në germën “c”, të këtij neni sanksionohet rasti kur zgjidhja e kontratës shkel ndalimin e diskriminimit, sipas përcaktimeve në këtë Kod dhe në ligjin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi*), të Kodit të Punës, si dhe ligjin nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Bazuar në sa më sipër, pala ankuese, në kërkesë padinë e paraqitur pranë Gjykatës, ka pretenduar *inter alia*, trajtimin e padrejtë dhe diskriminues nga ana e punëdhënësit/Shoqëria Alba Box sh.p.k, lidhur me largimin e saj nga puna, dhe ka kërkuar dëmshpërblimin përkatës si dhe rikthimin në punë, duke investuar kështu edhe Gjykatën për të njëjtat pretendime që ka sjellë paralelisht edhe pranë Komisionerit.

Në këtë kontekst, në kushtet që kjo çështje është duke u gjykuar nga Gjykata, bazuar në paragrafin 3, të nenit 36, të Kodit të Procedurës Civile, ku parashikohet se: “...Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata...”, si dhe në nenin 33, pikën 7/4 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “Kur Komisioneri vihet në dijeni se ankuesi ka paraqitur kërkesë padi në gjykatë me objekt konstatim diskriminimi, ndërkohë që ka paraqitur të njëjtën ankesë pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe çështja është në shqyrtim e sipër, Komisioneri merr vendim për pushimin e çështjes”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk mund të shprehet lidhur me ankesën me nr. 94, datë datë 30.04.2024, paraqitur nga znj.F.M , dhe deklaron pushimin e shqyrtimit të saj<sup>3</sup>.

Neni 33, pika 7/4 e LMD nuk e lidh marrjen dijeni me ndonjë moment të caktuar të procedurës. Kushti që kërkohet nga dispozita e sipërcituar është vetëm fakti që çështja të jetë në shqyrtim, pra të mos ketë përfunduar shqyrtimi i saj me vendim nga ana e Komisionerit.

Bazuar në nenin 36, pika 4, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se:

*“Gjykata mund t’i kërkojë Komisionerit, në çdo fazë të procedimit, që të paraqesë një mendim me shkrim, rezultatet e hetimit të tij, në qoftë se është bërë hetimi, ose çdo informacion tjetër që ka*

---

<sup>3</sup> Për analogji citojmë vendimet me: nr. 13, datë 28.01.2021, nr. 27, datë 16.02.2021, nr. 77, datë 07.05.2021, nr. 230, datë 25.11.2021, nr. 253, datë 28.12.2021, nr. 77, datë 21.04.2022, nr. 108, date 20.06.2023, nr. 145, datë 26.07.2023, nr. 89, datë 03.04.2024, nr. 175, datë 03.06.2024, të Komisionerit.

rëndësi për çështjen”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në rastin kur Gjykata e kërkon atë<sup>4</sup>, përgatit dhe paraqet mendimin me shkrim, lidhur me çështjen sa më sipër.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 36 të ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe referuar nenit 32, pika 1, shkronja a), nenit 33, pika 7/4, dhe nenit 36/4, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I:**

1. Pushimin e shqyrtimit të ankesës nr. 94, datë 30.04.2024, të paraqitur nga ankuesja znj. F.M , për shkak se çështja është duke u gjykuar nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

Shkaku: Gjinia, identiteti gjinor, gjendja shoqërore, gjendja familjare, gjendja civile, çdo shkak tjetër.  
Fusha: Punësim  
Lloji i vendimit: Pushim shqyrtimi\_Gjykatë

---

<sup>4</sup> Ose me kërkesë drejtuar Gjykatës, të palës së interesuar në procesin gjyqësor të iniciuar.